



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më 10/07/2020

V E N D I M

Nr. 8, datë 10/07/2020

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË QENDRAVE TË VOTIMIT NË KZF/KZI, SI DHE
MIRATIMIN E VULAVE TË KQV – VE DHE KRYETARIT**

Mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, neni 8, si dhe Urdhrin nr. 56, datë 01.07.2020 të Rektorit të UPT – së “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve:

V E N D O S I:

1. Të miratojë numrin e Qendrave të Votimit (QV) si më poshtë:

- FIN 2 Qendra Votimi;
- FTI 2 Qendra Votimi;
- FIM 2 Qendra Votimi;
- FAU 2 Qendra Votimi;
- FGJM 2 Qendra Votimi;
- FIE 2 Qendra Votimi;
- FIMIF 1 Qendër Votimi;
- IGJEUM 1 Qendër Votimi;

2. Të miratojë vulat për Komisionet e Qendrave të Votimit KQV – ve, si dhe Kryetarin e KQV – ve.

2.1 Vula e KQV – ve/ në përmbajtje do të ketë emërtimin: Universiteti Politeknik i Tiranës dhe emri i fakultetit/institutit përkatës. Në qendër të vulës të shkruhet teksti KQV, akronimi i fakultetit/institutit (psh. FIN), 2020.